



QEVERIA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Z. Edi Rama - Kryeministër

Znj. Senida Mesi - Zëvendëskryeministre

Z. Ditmir Bushati - Ministër për Europën dhe Punët e Jashtme

Znj. Olta Xhaçka - Ministre e Mbrojtjes

Z. Fatmir Xhafaj - Ministër i Brendshëm

Z. Arben Ahmetaj - Ministër i Financave dhe Ekonomisë

Z. Damian Gjiknuri - Ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Znj. Lindita Nikolla - Ministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Znj. Etilda Gjonaj - Ministre e Drejtësisë

Znj. Mirela Kumbaro Furxhi - Ministre e Kulturës

Z. Niko Peleshi - Ministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Znj. Ogerta Manastirliu - Ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Z. Blendi Klosi - Ministër i Turizmit dhe Mjedisit

Z. Pandeli Majko - Ministër Shteti për Diasporën

Znj. Sonila Qato - Ministre Shteti për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

PROGRAMI QEVERISËS

2017-2021

1	PREAMBUL	4
1.1	MANDATI 2013-2017	5
1.2	NJË VOTË PËR “SHQIPËRINË QË DUAM, SHTET-PUNË-MIRËQENIE”	7
2	RRITJE E QËNDRUESHME GJITHËPËRFSHIRËSE	8
2.1	STABILITETI MAKROEKONOMIK	9
2.2	ENERGJIA DHE BURIMET NATYRORE	9
2.3	BUJQËSIA	11
2.4	MJEDISI	12
2.5	INFRASTRUKTURA	12
2.6	TURIZMI DHE KULTURA	13
3	SHËRBIMET PUBLIKE	16
3.1	SHTETI LIGJOR DHE DREJTËSIA E RE	17
3.1.1	ADMINISTRATA PUBLIKE DHE DIGJITALIZIMI	17
3.2	ARSIMI, RINIA DHE SPORTI	19
3.3	SHËNDETËSIA DHE KUJDESI SOCIAL	20
4	POLITIKA E JASHTME DHE E SIGURISË, INTEGRIMI EUROPIAN DHE SHQIPTARËT NË BOTË	26

1. PREAMBUL

Më 25 qershor 2017 shqiptarët folën qartë. Vota e tyre erdhi si shprehje e drejtpërdrejtë e besimit dhe e mbështetjes së fortë që zgjedhësit shqiptarë dhanë për Partinë Socialiste dhe programin e saj qeverisës për “Shqipërinë që Duam”, një Shqipëri europiane, me shtet ligjor, ekonomi të zhvilluar, punësim dhe mirëqenie për çdo qytetar shqiptar.

Pa dyshim që është privilegj për ne, por është sidomos një sfidë shumë e madhe ky mandat i plotë për të qeverisur të vetëm. Duam t’ju sigurojmë që sikurse e treguam në mandatin e parë, kjo qeverisje do të ushtrohet në mënyrë të përgjegjshme, efikase, transparente, në interes të zhvillimit të vendit, duke zgjeruar pjesëmarrjen dhe kontributin e çdo shqiptari në vendimmarrje, duke ndërtuar besimin e plotë tek e ardhmja moderne e Shqipërisë, duke luftuar korrupsionin, informalitetin, klientelizmin, pabarazinë përpara ligjit, pandëshkueshmërinë apo diskriminimet e çdo lloji qofshin.

Nuk ka kush dyshim se rruga pa kthim e Shqipërisë është vetëm europiane, edhe sepse ajo i ka të gjitha mundësitë për të siguruar një zhvillim ekonomik gjithëpërfshirës e të prekshëm për çdo qytetar, duke i dhënë zgjidhje problemeve të lidhura me papunësinë, të ardhurat e ulëta, varfërinë që ende është e pranishme në mjaft familje shqiptare.

Qeverisja e katërvjeçarit 2017-2021, do të ketë në qendër të vëmendjes zbatimin e plotë të Reformës në Drejtësi, për të krijuar një shoqëri në themel të së cilës qëndron e drejta, merita dhe vlerat qytetare, sociale e profesionale të çdo individi, të një shoqërie solidare me shtresat në nevojë, të një shoqërie që në bosht ka drejtësinë sociale.

Në këtë dokument të Qeverisë për mandatin 2017-2021, ne sjellim në Kuvendin e Shqipërisë një program ambicioz, të qartë dhe të arritshëm në strategjitë dhe objektivat e tij.

Në mandatin që sapo u mbyll, 2013-2017, ne stabilizuar financat publike dhe përmbyllëm me sukses programin e bashkëpunimit me FMN, realizuam reforma të rëndësishme në sistemin fiskal, në sistemin e energjisë, në kontrollin e territorit, në fushën e legalizimeve, kryem reformën administrative - territoriale, reformën kundër informalitetit dhe reformën e pensioneve. Vendosëm taksimin e ndershtëm në favor të 97% të shqiptarëve, përmirësuar skemën e mbrojtjes sociale, përmirësuar shërbimet publike, veçanërisht në arsim dhe shëndetësi, iniciuam paketën e solidaritetit si shprehje e mirënjohjes për mbështetjen që edhe njerëzit më në nevojë i dhanë reformave. Forcuam rolin dhe pozitën e Shqipërisë dhe të shqiptarëve në rajon dhe në Europë, tashmë si një faktor me zë të fuqishëm dhe të sigurt në tryezat e bisedimeve dhe negociatave ndërkombëtare stabilizuese. Shqipëria konfirmoi kështu hapin e vet të sigurt e të qartë në rrugën e integritit europian.

Në këtë mandat të ri qeverisës ne synojmë të thellojmë rritjen ekonomike duke arritur në nivelin 5.5 - 6% në fund të mandatit; do të garantojmë stabilitetin makroekonomik dhe konsolidimin fiskal të vendit brenda parametrave më të mirë të dakordësuar me partnerët ndërkombëtarë; synojmë uljen graduale të borxhit publik nën nivelin 60%; rritjen e qenësishme të investimeve të huaja direkte dhe investimeve publike; rritjen e punësimin, duke e ulur kështu papunësinë në nivel njëshifror; rritjen e ndjeshme të pagave dhe pensioneve; përmirësimin e sistemit të ndihmës sociale; reduktimin drastik të nivelit të varfërisë; përmirësimin e klimës së biznesit dhe partneritetin me sipërmarrjen; synojmë një reformë tërësore në sistemin e ujit të pijshëm; realizimin e një sërë projektesh për rilindjen rurale; përmirësimin cilësor të arsimit, shëndetësisë dhe infrastrukturës; nxitjen e turizmit si burim i rëndësishëm ekonomie e zhvillimi; ofrimin e një qeverisjeje më të mirë dhe lehtësimin e shërbimeve për qytetarët e sipërmarrjen përmes komunikimit dhe teknologjisë.

1.1 MANDATI 2013-2017

Mandati 2013-2017 ishte mandati i jetëzimit të një ndryshimi të thellë, rrënjësor e të gjithanshëm, për të cilin qytetarët shqiptarë, njerëzit e zakonshëm të këtij vendi, na dhanë besimin e plotë dhe njëkohësisht edhe përgjegjësinë për ta thelluar më tej dhe për ta materializuar në politika konkrete edhe të prekshme, në çdo ditë të qeverisjes sonë.

Vizioni ynë ishte “Një Rilindje për Shqipërinë”.

Misioni ynë, ishte ndërtimi i “Shqipërisë së Gjeneratës Tjetër”. Funksioni ynë ishte mirëqeverisja për të përmbushur zotimet tona, për të vënë në jetë një sërë nismash e politikash të reja, duke promovuar një kulturë të re të ushtrimit të pushtetit.

Pas katër vitesh të qeverisjes sonë, Shqipëria ka një rritje ekonomike më të shpejtë e më të qëndrueshme, prej së cilës po përfitojnë gjithnjë e më shumë familjet dhe qytetarët. Rritja ekonomike sot është 3.5 herë më e lartë se në vitin 2013, duke e renditur Shqipërinë ndër vendet me ritmet më të larta të rritjes në Europë.

Në katër vjet u morën masa të rëndësishme dhe efikase për të rivendosur stabilitetin makroekonomik pas falimentimit që trashëguam, duke ia dalë të ulim ndjeshëm riskun fiskal në ekonomi dhe rikthimin e parametrave ekonomikë në nivele të qëndrueshme.

Qeveria e zhvilloi aktivitetin e saj në respekt të plotë të angazhimeve për konsolidimin fiskal duke e përmbullur mandatin e parë me sufiçit primar dhe duke vendosur nën kontroll borxhin publik, për herë të parë në 23 vjet edhe gjatë një viti elektoral. U ndërmorën reforma të rëndësishme strukturore për rimëkëmb-

jen e sektorëve të ekonomisë. Reforma në energji e ktheu sektorin nga një risk fiskal që i shkaktonte buxhetit të shtetit çdo vit 20 miliardë lekë humbje, në një burim potencial zhvillimi. Reforma e pensioneve shmangu falimentimin thuajse të sigurt të skemës dhe sot ka filluar të japë efektet e saj pozitive, duke vendosur një ekuilibër të shëndetshëm mes kontribuesve dhe përfituesve.

Me projektin e Rilindjes Urbane dhe planet e reja të zhvillimit urban, sot qytetet kanë një identitet të ri dhe model të ri në jetën shoqërore dhe komunitare, pasi iu dha fund ndërtimeve të paligjshme dhe në armiqësi me mjedisin dhe trashëgiminë kulturore. Në mandatin 2013-2017 janë rikonstruktuar rreth 300 mijë ml rrugë, rreth 20 mijë ml bulevarde dhe shëtitore, rreth 200 mijë m² sheshe dhe qendra urbane si dhe qendra historike, rreth 150 mijë m² parqe. Nga zbatimimi i këtyre projekteve, kanë përfituar mbi 1.8 milionë banorë në Republikën e Shqipërisë, si dhe rreth 3 mijë biznese të cilat ushtrojnë aktivitetin në zonat e transformuara prej tyre.

Falë ndërhyrjeve të ndërmarra gjatë mandatit të parë, ekonomia e vendit po formalizohet në çdo degë, financat publike janë konsoliduar dhe rreziqet për integritetin fiskal janë pakësuar. Tregjet financiare i përgjigjen ekonomisë shqiptare me pozitivitet. Programi ynë 3-vjeçar me FMN-në dhe Bankën Botërore u përmbyll me sukses. Besimi për ekonominë tonë është rritur, duke sjellë si rezultat vlerësimin në mënyrë konstante me nota pozitive nga agjencitë më prestigjioze ndërkombëtare.

Gjatë mandatit 2013-2017, Qeveria aplikoi Reformën Administrative-Territoriale, një nga reformat më të rëndësishme për të avancuar procesin e decentralizimit dhe fuqizimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore. Qeveria mbetet e vendosur për zbatimin e plotë të kësaj reforme pasi aplikimi i saj garanton përmirësimin e shërbimeve publike për qytetarët si dhe rritjen e efektivitetit të tyre.

Në 4 vitet e shkuara ne ia dolëm të përmirësonim rrënjësisht situatën e rendit dhe sigurisë publike në vend, rrjedhojë e drejtpërdrejtë e reformave të thella ligjore dhe institucionale që ndërmorem. Ky vlerësim për rendin dhe sigurinë në Shqipëri është njohur i tillë edhe nga institucione dhe organizata të ndryshme ndërkombëtare, por mbi të gjitha nga vetë qytetarët, përmes rikthimit të besimit të tyre tek Policia e Shtetit.

MË SHUMË MIRËQENIE E SHËRBIME PUBLIKE PËR QYTETARËT

Në mandatin 2013-2017 u shtuan rreth 200 mijë vende pune në sektorin jobujqësor. Falë rritjes së punësimit dhe reformave të ndërmarra, në Shqipëri sot ka më pak të varfër. Rreth 60 mijë per-

sona kanë dalë nga varfëria dhe rreth 29 mijë të tjerë nga mjerimi. Është krijuar më shumë akses në tregun e punës, në shërbimet publike, në arsim, në kujdes shëndetësor dhe në mbrojtjen sociale për këto shtresa në nevojë të shoqërisë.

Taksimi i ndershëm progresiv ishte në themel të qasjes sonë, duke u bazuar në parimin “kush fiton më shumë paguan më shumë dhe kush fiton më pak, paguan më pak”. Në mandatin 2013-2017 hoqëm barrën e taksës së sheshtë duke rritur të ardhurat reale për 97% të shqiptarëve. Edukatorët, mësuesit, pedagogët, infermierët, mjekët, policët, ushtarakët, zjarrfikësit, nëpunësit, të vetëpunësuarit dhe punonjësit me paga të ulëta në sektorin privat, përfituan drejtpërsëdrejti si rezultat i këtij ndryshimi. Vetëm përmes taksës progresive, iu rikthyem qytetarëve shqiptarë rreth 48 miliardë lekë në katër vitet e qeverisjes sonë.

Konsumi i familjeve ka pasur rritjen më të lartë në shtatë vitet e fundit. Sot, një qytetar shqiptar konsumon rreth 44 mijë lekë në vit më shumë se në vitin 2013. Të ardhurat e disponueshme për banor, kanë arritur në 580 mijë lekë ose 16% më të larta se në vitin 2013.

Sëmundja nuk taksohet. Hoqëm TVSH-në e barnave dhe shërbimeve mjekësore. Sot, ilaçet janë 30% më të lira se katër vite më parë, ndërsa mjeku i familjes dhe kontrolli bazë janë falas për çdo qytetar. 600 mijë të pasiguruar përfitojnë nga lista e ilaçeve të rimbursueshme dhe mjeku i familjes falas.

Ne krijuam vetëdijen se energjia është një produkt jetësor për të gjithë dhe gjithkush duhet të paguajë atë që konsumon. Ne mbështesim maksimalisht familjet në nevojë pa dëmtuar të mirën e përbashkët.

Ne hoqëm nga sistemi universitetet që prodhonin diploma pa vlerë, rritëm cilësinë e dijeve dhe shprehive, filluam botimin e teksteve me standarde të BE-së, zgjeruam aksesin në arsim për fëmijët deri në 5 vjeç dhe po ndërtojmë universitete autonome, konkurruese, bazuar në meritë e që kontribuojnë në ekonominë e dijes. Gjatë mandatit 2013-2017 iu dyfishua numri i nxënësve në arsimin dhe formimin profesional.

Kulturën e nxorëm nga gjendja e emergjencës dhe e improvizimit dhe e kthyem në burim emancipimi dhe zhvillimi ekonomik. Me paketën e solidaritetit kemi rritur përkujdesjen për të moshuarit, shtresat në nevojë dhe punëtorët e profesioneve të vështira si minatorët dhe naftëtarët. Pensioni social iu ka dhënë mundësi të moshuarve të plotësojnë nevojat minimale, por dhe shpresën se nuk do të jenë kurrë më të harruar.

SIPËRMARRJE KONKURRUESE DHE PARTNERE E ZHVILLIMIT

Sot, sipërmarrja është më e mbrojtur nga konkurrenca e pandershme dhe informaliteti, partnerë e Qeverisë në projektet e zhvillimit dhe në dialog të vazhdueshëm në funksion të përmirësimit të klimës së biznesit.

Viti 2016 shënoi një rekord historik të investimeve të huaja direkte me rreth 133 miliardë lekë, ndërsa numri i bizneseve të huaja në Shqipëri po rritet.

Paguam rreth 77 miliardë lekë detyrime të prapambetura ndaj sipërmarrjes dhe qytetarëve, rishikuar legjislacionin bazë të financave publike për të siguruar konsolidimin e tyre dhe hartuam strategjinë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të reja. Hoqëm taksën e biznesit të vogël. Mbështetja jonë për sipërmarrjet e vogla u materializua me heqjen e taksës për biznesin e vogël, zgjerimin e tatimit për bizneset me xhiro vjetore deri në 5 milionë lekë, prej nga përfituan 83 mijë familje; vendosëm vetëm 5% tatim-fitimi për bizneset me xhiro vjetore nga 5-8 milionë lekë, prej nga përfitojnë 17 mijë biznese; 93% të bizneseve të vogla ose 100 mijë biznese, u lehtësuan nga barra tatimore, ndërsa u aplikuan 60 lehtësira fiskale për sipërmarrjen.

Një hov të dukshëm mori turizmi, të ardhurat e të cilit i kaluan 200 miliardë lekë në vitin 2016.

Me politikat tona të mbështetjes së prodhimit bujqësor, agroindustrial dhe industrisë së lehtë dhe me investimin prej 16.5 miliardë lekë që përmirësoi ndjeshëm sistemin e ujitjes, ne shmangëm efektet negative nga tregjet ndërkombëtare, ruajtëm konkurrueshmërinë e ekonomisë dhe produkteve shqiptare, çka solli rritje të ndjeshme të eksporteve bujqësore.

REFORMA NË DREJTËSI

Këmbëngulëm dhe arritëm konsensusin e plotë politik për miratimin e Reformës në Drejtësi. Një Shqipëri më e drejtë është nevojë jetike; ashtu siç janë jetike respektimi i Kushtetutës, ndarja e pushteteve, zbatimi i ligjit dhe barazia para tij.

Përmes Drejtësisë, ne garantojmë një qeverisje funksionale dhe të përgjegjshme, si një kontratë e ligjshme, e monitorueshme dhe e kontrollueshme mes të zgjedhurve dhe qytetarëve të lirë. Ne synojmë edhe më shumë, një qeverisje efikase qendrore, në ekuilibër të plotë dhe ndarje të qartë të përgjegjësisë me qeverisjen vendore, si bartësen e demokracisë funksionale.

PERSPEKTIVA EUROPIANE E SHQIPËRISË

Falë arritjeve të reformave ambicioze e gjithëpërfshirëse, Shqipëria siguroi statusin e vendit kandidat për anëtarësim në BE, si një hap në realizimin e aspiratës europiane të vendit tonë dhe tashmë përgatitet për fillimin e negociatave të anëtarësimit.

1.2 NJË VOTË PËR “SHQIPËRINË QË DUAM, SHTET-PUNË-MIRËQENIE”

Vota e 25 Qershorit është një mesazh i qartë i shoqërisë sonë për të çuar përpara reformat e vështira, por jetike të ndërmarra në mandatin 2013-2017, si dhe për të mbështetur platformën e paraqitur nga Partia Socialiste si alternativë qeverisëse.

Ky mandat i plotë për qeverisje, është mundësia dhe përgjegjësia jonë për të jetësuar vizionin tonë politik; për të avancuar reformat e rëndësishme e transformuese; për të kryer atë çka nuk mundëm në katër vitet e kaluara; për ta bërë “Shqipërinë që Duam” një realitet të kudondodhur nga veriu në jug, përmes një bashkëqeverisjeje reale dhe të përditshme me njerëzit e zakonshëm të këtij vendi.

Në kuadër të komunikimit dhe transparencës në qeverisje, dialogu me qytetarët i zhvilluar pas 25 Qershorit thekson nevojën për të gjetur zgjidhje për shqetësimet e tyre kryesore: rritjen e punësimit; përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike, sidomos në fushën e shëndetësisë, arsimit, ujit të pijshëm, administrimit të mbetjeve, regjistrimit të pronës dhe hipotekave; transparencën e qeverisjes në nivel qendror e lokal; përmirësimin e shërbimeve dhe performancës së administratës shtetërore; përmirësimin dhe kompletimin e infrastrukturës; arsimin profesional etj.

2. RRITJE E QËNDRUESHME GJITHËPËRFSHIRËSE

Rritja ekonomike cilësore, inteligjente dhe gjithëpërfshirëse mbetet burim kryesor në përmirësimin e jetës së qytetarëve. Gjatë mandatit 2017-2021, Qeveria do të angazhohet me prioritet në konsolidimin e stabilitetit makroekonomik, rritjen e punësimit, zhvillimin e infrastrukturës, sektorit energjetik e minerar, bujqësisë, agroindustrisë dhe turizmit.

Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet politikave ekonomike e financiare që stimulojnë investimet në drejtim të rritjes dhe të zgjerimit të industrializimit nëpërmjet shtimit të aktiviteteve me karakter industrial. Kjo do të synojë rritjen e kapaciteteve prodhuese e përpunuese të sektorit industrial në Shqipëri. Përqendrimi i vëmendjes drejt rritjes së nivelit të industrializimit të lehtë të vendit përbën një nga prioritetet e qeverisjes sonë në mandatin 2017-2021.

2.1 STABILITETI MAKROEKONOMIK

Përmes zbatimit të plotë të këtij programi ne synojmë një rritje ekonomike mesatare rreth 4.5 përqind për të arritur në rreth 5.5 - 6 përqind të PBB-së në fund të mandatit.

Programi 2017-2021 rikonfirmon konsolidimin fiskal si një objektiv prioritar të tij. Qeveria Shqiptare angazhohet për uljen graduale të borxhit publik në rreth 60% të PBB-së deri në fund të mandatit.

Investimet publike të financuara nga buxheti i shtetit do të jenë rreth 5% e PBB-së. Jemi të vendosur për të vazhduar përdorimin e instrumenteve financiare, si Partneriteti Publik - Privat, për projekte me rëndësi të veçantë në ekonomi, për të siguruar investime në infrastrukturë dhe shërbime publike të domosdoshme për qytetarët dhe për rritjen ekonomike të vendit.

Me paketën “1 Miliard” do të injektojmë më shumë se 100 miliardë lekë në ekonomi, nëpërmjet angazhimit të kapitaleve private në një numër të madh projektsh investuese, duke ndikuar direkt në rritjen ekonomike dhe zhvillimin e sektorëve prioritarë.

Pas rritjes së të ardhurave buxhetore me rreth 3.7% të PBB-së gjatë mandatit 2013-2017, angazhimi i Qeverisë për mandatin 2017-2021 është sigurimi i të ardhurave në nivelin 28% të PBB-së. Ky synim mbështetet në zbatimin e Strategjisë së Manaxhimit të Financave Publike 2014-2020, ku kontribut kryesor do të kenë rritja ekonomike, lufta kundër informalitetit, zhvillimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit të administratave fiskale për të rritur efikasitetin e punës, zhvillimi i mëtejshëm i kuadrit legjislativ fiskal, si dhe forcimi i burimeve njerëzore të administratës.

Politika fiskale e katër viteve të ardhshme do të orientohet drejt qëndrueshmërisë dhe nxitjes së sektorëve prioritarë. Progresiviteti

do të vazhdojë të jetë në qendër të filozofisë sonë fiskale.

Ne do të vazhdojmë përkrahjen e sipërmarrjes me masa fiskale, përveç lehtësive procedurale që tashmë janë aplikuar. Gjatë mandatit të dytë synohet që:

- Tatimi mbi të ardhurat personale për fashën e lartë të të ardhurave nga paga të ulët në 18%.
- Tatimi mbi dividendin të reduktohet në 6%
- Tatim-Fitimi për prodhimin në Teknologjinë e Informacionit për të nxitur zhvillime në një industri të domosdoshme për zhvillimin ekonomik afatgjatë të shkojë në 5%
- T'u jepet ndihmë familjeve të reja për blerjen e shtëpisë së parë, duke njohur si shpenzime të zbritshme interesat e kredive të marra për këtë qëllim.

2.2 ENERGJIA DHE BURIMET NATYRORE

Në fushën e energjisë, Qeveria do të synojë zhvillimin e mëtejshëm të sektorit elektroenergjetik, duke e shndërruar atë në një sektor të qëndrueshëm financiarisht, operacionalisht dhe teknikisht, të aftë për të plotësuar kërkesën në rritje për energji brenda vendit, duke pasur si prioritet integrimin e tregut vendas të energjisë në tregjet rajonale dhe ata europiane, dhe duke ulur varësinë nga importi.

Politika e Qeverisë në këtë mandat të ri do të vazhdojë të orientohet drejt rritjes të sigurisë së furnizimit me energji të konsumatorëve, duke pasur për objektiv mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të vendit, nëpërmjet rritjes së punësimit dhe promovimit të energjisë së rinovueshme dhe efikasitetit të energjisë, duke stimuluar konkurrencën në treg, duke siguruar stabilitet dhe minimizuar kostot për konsumatorët shqiptarë, si dhe duke garantuar mbrojtjen e mjedisit.

Në sektorin elektroenergjetik - Qeveria do të synojë thellimin e reformës dhe vazhdimin e programit të investimeve, për të garantuar sigurinë dhe cilësinë e furnizimit për të gjithë përdoruesit fundorë të saj, në këto drejtime kryesore: (a) rritje të kapaciteteve gjeneruese; (b) diversifikim të burimeve gjeneruese; (c) rritje të kapaciteteve transmetuese ndërkuftare dhe brenda vendit për të garantuar furnizim të vazhdueshëm të vendit me energji, stabilitet dhe cilësi në furnizim; (e) vazhdimin e procesit të ndarjes së OSHEE sipas ligjit të sektorit të energjisë elektrike, ulje të vazhdueshme të humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, garantimin e aksesit për burimet e reja dhe zhvillimin e tyre; (f) krijimin e bursës së energjisë dhe krijimin e tregut të organizuar të energjisë; (g) forcimin e pavarësisë së rregullatorit; (h) integrimin e tregut me tregun e Kosovës dhe atë rajonal; (i) përafrimin e plotë të të gjithë legjislativitetit të sektorit me atë europian; (j) stimulim të investimeve; (k) vazhdim të betejës pa kompromis me korrupsionin dhe vjedhjen e energjisë elektrike.

Gjenerimi synon kryerjen e 22.6 miliardë lekë investime për forcim të kapaciteteve gjeneruese të sektorit publik. Realizimi i projekteve të reja gjeneruese brenda mandatit të ardhshëm qeverisës, si dhe vënia në funksionim e planit të rimëkëmbjes së sektorit të energjisë elektrike në pjesën e gjenerimit (KESH), do të jenë një mbështetje e rëndësishme për ekonominë kombëtare dhe me kontribut në rritjen e të ardhurave kombëtare.

Transmetimi i energjisë elektrike do të realizojë një total investimesh prej rreth 21.3 miliardë lekë. Në pikpamjen strategjike, projekti për ndërtimin e linjës së interkonjeksionit 400 kV Elbasan2 (Shqipëri) – Bitola (Maqedoni) dhe Elbasan2 – Fier, si dhe zgjerimi i nënstacioneve Elbasan2 dhe Fier, përforcon lidhjet interkonektive me rajonin, duke krijuar kushte për shkëmbime tregtare dhe tranzitime pa kufizim të energjisë elektrike në rajon. Me prioritet do të jenë projektet e investimeve, të cilat do të kenë impakt në reduktimin e humbjeve të energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit. Këto projekte do të garantojnë gjithashtu furnizimin me energji elektrike pa kufizim dhe me cilësi nga rrjeti i transmetimit të objekteve të rinj industrialë dhe të gjithë përdoruesve të rinj në të ardhmen në këto rajone.

Në këtë sektor pritet të realizohet një total investimesh prej rreth 70 miliardë lekë (rreth 50 miliardë lekë investime nga buxheti publik në rrjetin e shpërndarjes dhe 5.3 miliardë lekë të Bankës Botërore, 6.6 miliardë lekë me financim të KfW për sistemin Skada dhe rreth 6.6 miliardë lekë investim për leximin e matësve smart) për periudhën 2017-2021.

Qeveria do vazhdojë të nxisë rritjen e prodhimit të **energjisë prej burimeve të rinovueshme** për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm me qëllim rritjen e diversifikimit të burimeve nga energjitë alternative të qëndrueshme dhe miqësore me mjedisin, si dhe implementimin e skemave të reja të matjes neto të energjisë nga impiantet e prodhimit të energjisë diellore dhe me erë për të gjithë vetëprodhuesit, konsumatorë familjarë apo biznese. Në sektorin e energjive të rinovueshme, investimet e pritshme në ngritjen e impianteve të gjenerimit të energjisë nga burimet diellore janë rreth 20 miliardë lekë, ku deri në 2020-ën do të instalohen rreth 50 MW me tarifë të rregulluar dhe nga burimet me energjinë e erës, investimet e pritshme do të jenë afërsisht rreth 8 miliardë lekë, ku deri në vitin 2020 do të instalohen 30 MW me tarifë të rregulluar.

Përsa i takon burimeve të reja ujore, Qeveria do të ruajë ritmin e rritjes së këtyre burimeve, duke krijuar një klimë të favorshme investimi për ta, me një pritshmeri për investime të ardhshme private me rreth 53.2 miliardë lekë, me një kapacitet rreth 300 MW të instaluar. Qeveria do të ndjekë politikën e rritjes së garancisë dhe sigurisë afatgjatë për investimet e realizuara në burimet hidro, duke transformuar kontratat në përputhje edhe me praktikën më të mira europiane për të drejtat e administrimit dhe pronësisë.

Në sektorin e efikasitetit të energjisë, deri në vitin 2021 me krijimin e Agjencisë së Efikasitetit të Energjisë dhe Fondit për Efikasitetin, investimet e pritshme në sektorin publik dhe privat në drejtim të efikasitetit të energjisë do të jenë rreth 10.6 miliardë lekë. Objektiv i ynë është reduktimi me 6.8% i konsumit të energjisë dhe të ardhurat e pritshme për ekonominë kombëtare nga kursimi i energjisë do të jenë rreth 14.6 miliardë lekë.

HIDROKARBURET

- Nafta dhe gazi

Në operimin e kërkim-prodhimit të naftës do të synohet që (a) gjithë vendburimet naftëmbajtëse në tokë dhe det të jenë objekt i kontraktimit nga investitorë seriozë; (b) të kemi një portofol investimesh 4-vjeçar deri në 110 miliardë lekë; (c) të promovohet tek operatorët modeli i ri ekonomik i kontratave; (d) të rriten kapacitetet transportuese; (e) të ristrukturohet kompania publike AlbPetrol sh.a. duke ruajtur një njësi teknike dhe privatizuar asetet e tjera; (f) të forcohet roli rregullator i AKBN; (g) të garantohet depozitimi sipas standardeve për hidrokarburete; (h) të rriten kapacitetet prodhuese e tregtuese të produkteve të biokarburanteve; (i) të rritet forca ndëshkuese në zbatimin e normave të sigurisë dhe cilësisë.

Në përpunimin e naftës do të synohet të përpunohet e gjithë sasia që prodhohet dhe destinohet në tregun shqiptar.

Në operimin e gazit natyror të prodhuar në vend synohet (a) të forcohen kapacitetet tregtuese dhe teknike; (b) të fuqizohet operatori publik AlbGaz sh.a; (c) të promovohet diversifikimi përmes gazit natyror; (d) të zhvillohen projektet e gazsjellësit adriatiko-jonian (IAP), gazsjellësit Shqipëri-Kosovë.

- Industria minerare

Qeveria do të mbështesë edhe më tej zhvillimin e kapaciteteve prodhuese dhe përpunuese në industrinë minerare, duke synuar rritjen e eksporteve të produkteve të përpunuara metalore e jometalore. Përveç rritjes së punësimit dhe mirëqenies për banorët e zonave mineralmbajtëse, ky zhvillim do t'i japë një hov ekonomisë kombëtare në tërësi dhe përmirësojë bilancin tregtar të vendit. Qeveria do të angazhohet për shtimin e investimeve private në kërkim-prodhimin e mineralit të kromit dhe atë të bakrit. Do të nxitet ringjallja e industrisë së hekur-nikelit, duke kaluar nga fazat e zbulimit drejt asaj të shfrytëzimit. Përmes stimulimeve fiskale do të mund të zgjerohet industria përpunuese e mineraleve të prodhuara në vend. Krijimi i fabrikave dhe impianteve të reja të pasurimit dhe përpunimit do të synojnë ciklin e mbyllur në mineralet e kromit, ferrokromit dhe bakrit. Do të vazhdojë monitorimi i rreptë i zbatimit të rregullave teknike në miniera dhe zhvillim të industrisë në harmoni me mjedisin.

2.3 BUJQËSIA

Do të zhvillojmë më tej vizionin tonë për zhvillimin rural, si mundësia kryesore për të siguruar një rritje harmonike dhe të qëndrueshme të zonave rurale. Zhvillimi ekonomik në zonat rurale do të shihet i ndërthurur me sektorë të tjerë si turizmi, infrastruktura dhe shërbimet.

MBËSHËTETJA FINANCIARE

Në katër vitet e ardhshme do të financohen në zonat rurale rreth 25.5 miliardë lekë në mbështetjen e sektorit bujqësor, në përmirësimin e infrastrukturës rrugore në zonat rurale, mbështetjen e fermerëve dhe rritjen e aksesit në tregje.

Rritja e produktivitetit në fermat e mëdha do të vazhdojë të mbështetet me më shumë se 7.8 miliardë lekë të siguruar nga programi IPARD. Këto fonde do të përmirësojnë prodhimin, përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore për të rritur sasinë dhe sigurinë ushqimore të tyre.

Do të përjashtojmë nga TVSH inputet bazë kryesore bujqësore

INVESTIMET NË UJITJE – KULLIM

Pas dyfishimit të sipërfaqes së tokës bujqësore nën sistemin e vaditjes gjatë mandatit të parë, ne do të vazhdojmë investimet me synimin ‘ujë në çdo parcelë’ si dhe përmirësimin e kullimit përmes thellimit të decentralizimit dhe rritjes së investimeve në sektor.

KONSOLIDIMI I FERMËS, PROMOVIMI I EKONOMISË SË SHKALLËS

Madhësia mesatare e fermës në Shqipëri është ende e vogël dhe e fragmentarizuar. Një pjesë e posaçme e ndihmës në bujqësi do të përdoret për të inkurajuar konsolidimin dhe krijimin e fermave të mëdha, me qëllim rritjen e produktivitetit, uljen e kostos së prodhimit dhe rritjen e konkurrencës së produkteve bujqësore.

Procesi i konsolidimit të pronës në tokat bujqësore, i cili filloi në mandatin e parë qeverisës do të përmbyllet në këtë mandat, duke ulur pasigurinë mbi pronën në zonat rurale. Reforma e pronës do të krijojë terrenin institucional që të gjithë tokat bujqësore të pajisen me çertifikata pronësie; do të përmirësohen strukturat bujqësore edhe nëpërmjet lehtësimit të problemit të tokave djerrë (8% e tokës bujqësore), duke zbatuar instrumente fiskale nxitëse. Këto masa do të shoqërohen me mbështetje specifike për fermat me sipërfaqe mbi 5 ha.

Ngritja e sistemit transparent të ndihmës direkte dhe këshillimit në një sportel të vetëm, do të garantojë një shërbim të specializuar, në përputhje me karakteristikat e fermave dhe do të ulë

burokracinë e korrupsionin në akordimin e mbështetjes.

SIGURIA USHQIMORE

Siguria ushqimore mbetet prioritet i qeverisjes në mandatin e dytë, në forcimin e qasjes “nga ferma në tavolinë”, jo vetëm për produktet blegtorale, por edhe për produktet bujqësore. Instrumentet e aplikuara gjatë mandatit të parë qeverisës për uljen e nivelit të informalitetit, kanë krijuar premisat për rritjen e kontrollit të origjinës së produkteve bujqësore dhe blegtorale dhe për të rritur nivelin e sigurisë ushqimore në tregjet bujqësore, blegtorale dhe në industrinë agroushqimore.

Zhvillimi i Treguesve Gjeografikë të Origjinës (TGJO) është alternativa që do të nxitet për katër vitet në vazhdim për krijimin e një shporte produktesh TGJO-sh shqiptare. Skema të veçanta mbështetje do të ngrihen për grupe prodhuesish të cilët regjistrojnë produktet e tyre si TGJO.

PESHKIMI DHE AGROINDUSTRIA

Do t'i kushtohet një vëmendje e posaçme zhvillimit të sektorit të peshkimit, prodhimit dhe përpunimit të mishit, zgjerimit të sipërfaqes dhe prodhimit në serra, zhvillimit të sektorit të frutikuturës dhe nënprodukteve të tyre. Do të vazhdojë mbështetja për zgjerimin dhe modernizimin e industrisë përpunuese agroushqimore. Forcimi i kompetencave profesionale dhe zbatimi i standardeve cilësore të prodhimit në sipërmarrjet agropërpunuese do të jetë prioritetet në këtë drejtim. Do të vazhdojë kreditimi me kushte lehtësuese i agrobiznesit me 12.6 miliardë lekë.

Do të konsolidohet sistemi i statistikave bujqësore, proces i cili do të zhvillohet njëkohësisht me kontabilizimin e aktivitetit ekonomik të fermave bujqësore që i drejtohen tregut.

Zhvillimi i qëndrueshëm i akuakulturës brenda Zonave të Përcaktuara për Akuakulturën (ZPA), do të rritet me 70 %.

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT RURAL

Strategjia e zhvillimit rural do të synojë diversifikimin e aktiviteteve ekonomike jobujqësore në zonat rurale. Qeverisja jonë do të krijojë hapësira dhe mekanizma nxitës që zonat rurale të mos jenë ekskluzivisht bujqësore në ekonominë e tyre, por të nxiten edhe forma të tjera zhvillimi.

Në këtë mandat “Rilindja rurale” do të jetë programi i integruar i zhvillimit të qendrave të banuara, zonave me interes turistik, apo i zonave rurale në të cilat do të synohet përmirësimi infrastrukturës, vlerësimi i traditave dhe trashëgimisë kulturore, rritja e nivelit të shërbimeve publike, përmirësimi estetik i qendrave të banuara që i jep mundësi zonave të caktuara rurale të kenë një trend pozitiv zhvillimi ekonomik, të diversifikuar dhe të qëndrueshëm, duke krijuar njëherazi edhe premisat për zhvillimin e turizmit dhe agroturizmit.

2.4 MJEDISI

Mjedisi është jo vetëm pasuri e shumëllojshme ekosistemesh, por edhe një burim ekonomie që duhet përdorur me kujdes e strategjikisht dhe ne jemi të vetëdijshëm për detyrimin institucional, social dhe moral që të mirëmenaxhojmë dhe mbrojmë këtë pasuri kombëtare në interes të qytetarëve dhe të brezave që vijnë.

Parandalimi dhe kufizimi i erozionit është i lidhur direkt me përmirësimin e kushteve të mjedisit dhe në plan afatgjatë ndikon drejtpërdrejt cilësinë e jetesës. Për këtë qëllim, ne kemi parashikuar pyllëzim me ritme të shpejta dhe ngritje të veprave të natyrave të ndryshme hidroteknike, me qëllim disiplinimin e rrjedhës së ujërave në shtretërit e lumenjve.

Përmirësimi i cilësisë së ajrit përbën një tjetër prioritet mjedisor të Qeverisë. Gjatë këtij mandati do të instalojmë pajisje monitorimi të ndotësve të ajrit në 12 qytetet kryesore në vend.

Qeveria do të hartojë Planin Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të zonave të mbrojtura (ZM), Parqeve Kombëtare (PK), Rezervateve Natyrore Strikt (RNS), për të mbrojtur ekosistemet e tyre, por edhe për t'i integruar ato në një plan afatgjatë me projektet infrastrukturore dhe turistike.

Trajtimi i mbetjeve si lëndë të para do të bëhet në përputhje me konceptin e sistemeve të ekonomive qarkulluese, në shërbim të përdorimit me kriter dhe ruajtjes së burimeve të lëndëve të para.

2.5 INFRASTRUKTURA

Pas miratimit të Planit Kombëtar për Integrimin Europian 2017 - 2020, objektivi kryesor i qeverisë shqiptare vazhdon të mbetet përshpejtimi i integritimit të sistemit të transportit, si një parakusht për zhvillimin e sektorëve të tjerë të ekonomisë.

TRANSPORTI RRUGOR

Qëllimi i Qeverisë shqiptare është integrimi i sistemit rrugor në rrjetet ballkanike dhe në sistemin Paneuropean të Transportit. Objektivi afatshkurtër do të jetë sigurimi i zbatimit të marrëveshjes ndërkuftare me Malin e Zi, si pjesë e projektit të autostradës Adriatiko-Joniane, ndërsa ai afatmesëm lidhet me rritjen e efikasitetit të marrëveshjeve të tjera ndërkuftare.

Ndër projektet më prioritare të Qeverisë Shqiptare do të jenë: rrjeti qendror TEN-T Core; korridori Adriatiko – Jonian; akset Fushë-Krujë – Shkodër (zgjerim); Thumanë-Kashar/Vorë; dhe by-pass -et Tepelenë, Lezhë dhe Tiranë; ROUTE 7: ndërtimi dhe dublimi i aksit Milot – Rrëshen; rrjeti kombëtar: përfundimi i by-pass -it të Fierit dhe atij të Vlorës; ndërtimi i Rrugës së Arbërit.

Qeveria do të ndjekë një sërë praktikash efektive si stimuj financiarë për automjete më të pastra dhe më të efektshme; nxitjen e transportit ekologjik ndaj mjedisit; sistem inteligjent për transportin; rrethrotullime dhe krijimi i by-pass -ve në rrugë kombëtare si dhe në zona rurale.

TRANSPORTI HEKURUDHOR

Objektivat e Qeverisë shqiptare për transportin hekurudhor janë:

- Përgatitja e një masterplan-i mbi investimet e mundshme duke ngritur një sistem të transportit të shpejtë hekurudhor për udhëtarë, për zonat turistike dhe me përqendrim të lartë urban (modeli i linjës së shpejtësisë së lartë Tiranë-Rinas-Durrës).
- Projekt mbi lidhjen e linjës mes Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë, duke e futur rrjetin hekurudhor në kontekstin e një rrjeti rajonal të transportit hekurudhor, gjë e cila do të ndikonte në transformimin e Porteve të Durrësit, Shëngjinit dhe Vlorës si porte referencuese rajonale. Qeveria do të ketë përparësi zhvillimin e trekëndëshit tranzit Hani i Hotit – Durrës – Maqedoni e anasjelltas, gjë e cila do të rrisë ndjeshëm volumet e transportit me vendet fqinj.
- Zhvillimin e një kuadri ligjor gjithëpërfshirës për transportin hekurudhor, përfshirë një kod të ri hekurudhor, i cili do të zhvillojë një treg të hapur për operacionet dhe ndërveprimet me standarde teknike për shpejtësi të mëdha;

TRANSPORTI DETAR

Vendi përfiton nga një linjë bregdetare prej 440 km dhe ndodhet në një pozicion strategjik në detet Adriatik dhe Jon. Shqipëria do të veprojë si një qendër tranziti për vendet fqinje pa dalje në det si Maqedonia dhe Kosova.

Zhvillimi i porteve detare do të konsistojë në:

- specializimin dhe zhvillimin e harmonizuar të tyre, duke rehabilituar dhe ristrukturuar infrastrukturën portuale;
- ofrimin e shërbimeve tregtare nga /ose në bashkëpunim me sektorin privat - Niveli i menaxhimit të porteve detare, por edhe grupe të tjera të interesit do të orientohen më shumë në përmirësimin dhe në zgjerimin e numrit të shërbimeve që ofrohen në këto porte.

Qeveria shqiptare do të marrë të gjitha masat që t'i kushtojë vëmendjen e duhur mbrojtjes së mjedisit në hapësirën ujore nëpërmjet:

- kontrollit dhe monitorimit të vazhdueshëm të parametrave të ujit të detit;
- reduktimit të sasisë së mbetjeve të ngurta dhe vajore dhe trajtimi i tyre sipas normave të caktuara europiane;

- hartimit të planeve të emergjencës dhe procedurave operative për përballimin e incidenteve apo situatave të mundshme të emergjencës mjedisore;
- krijimit të strukturave të nevojshme dhe kompletimi i tyre me personelin e përshtatshëm për kryerjen e detyrave të mësipërme.

TRANSPORTI AJROR

Në përputhje me Planin Kombëtar për Integrimin Europian, lidhur me fushën e transportit ajror, objektivat kryesore të Qeverisë për vitet e ardhshme janë:

- ndërtim infrastrukturor aeroportual në jug të vendit
- përfshirja e shpejtë e Shqipërisë me të drejta të plota në Zonën e Përbashkët Europiane të Aviacionit, si dhe në Iniciativën Europiane “Qielli i Vetëm Europian” (Single European Sky), nëpërmjet përafrimit të legjislacionit të përcaktuar në Marrëveshjen Shumëpalëshe të ZPAE-së;
- forcimi i kapaciteteve administrative dhe rritja e performancës së Autoritetit të Aviacionit Civil, me qëllim ushtrimin e plotë të funksioneve mbikëqyrëse në përputhje me standardet përkatëse.

INFRASTRUKTURA UJORE

Për ne është domosdoshmëri ndjekja e një qasjeje sektoriale për ujin nëpërmjet ndërtimit të një sistemi të integruar qeverisjeje dhe menaxhimi. Për jetësimin e kësaj qasjeje, mbështetur në parimet e gjithëpërfshirjes dhe transparencës, do të hartohet dhe zbatohet një Program Kombëtar Sektorial afatgjatë (2018 – 2030), në të cilin do të synohet të harmonizohen veprimet dhe nismat që do të ndërmerren nga qeverisja qendrore dhe qeverisja vendore (tashmë në kuadër të decentralizimit të shumë funksioneve), sikurse dhe me të gjithë aktorët të tjerë, duke përfshirë partnerët zhvillimorë, shoqërinë civile, sipërmarrjen private, etj.

Në këtë mandat do të përmbushim nevojat e përdoruesve të ujit.

Kjo do të realizohet përmes:

- shtrirjes së shërbimit të furnizimit me ujë, që do të arrijë në nivel kombëtar në masën 75 %.
- shtrirjes së rrjeteve të kanalizimeve për largimin e ujërave të ndotur urbanë, që do të arrijë në nivel kombëtar në masën 48 %.
- mbulimit të sipërfaqeve të tokave bujqësore me infrastrukturë ujëtare e kullimi, që do të rritet me 40'000 ha për ujitjen dhe 70'000 ha për kullimin
- Plotësimi i nevojave të industrisë me ujë, me synim garantimin e ujit në sasinë dhe cilësinë e nevojshme do të jetë 100 %.

Krijimi i Këshillit Kombëtar të Ujit dhe i Sekretariatit Teknik të Ujit, si edhe i gjithë kuadri ligjor dhe institucional i ndërtuar me sukses në mandatin e parë, do të sigurojë ndërveprimin efikas dhe funksional në kontekstin e një qasjeje sektoriale të integruar, duke synuar një ndarje të qartë të roleve dhe përgjegjësisë në çdo nivel të qeverisjes.

Rritja e performancës së shoqërive lokale do të fillojë së pari nëpërmjet një aksioni kombëtar për pastrimin e rrjetit nga lidhjet e paligjshme; për pajisjen e subjekteve të të gjitha kategorive (familjare, biznese dhe buxhetore) me matës; për mbledhjen apo trajtimin në vazhdimësi të detyrimeve të prapambetura; për rritjen e arkëtimeve në nivele jo më pak se normat e lejuara europiane dhe zvogëlimin e humbjeve në rrjet jo më shumë se 20%.

2.6 TURIZMI DHE KULTURA

TURIZMI SI PRIORITET

Në vitet e fundit, industria e Turizmit ka rritur kontributin e saj në ekonominë e vendit në terma monetarë dhe në ato të punësimit.

Në katër vitet e ardhshme, Qeveria do të nxitë diversifikimin e turizmit në mënyrë që të kemi një turizëm më të qendrueshëm dhe gjithëvjeter. Objektivat që synohen janë:

- Centralizimi i procesit të planifikimit në turizëm, reformim i institucioneve, agjencive që merren me turizmin.
- Vendosje e rregullt në treg e të gjithë operatorëve ekonomikë në fushën e turizmit (agjenci, operatorë turistikë, udhërrëfyes dhe struktura mikpritëse).
- Përmirësimi i legjislacionit do të shoqërohet edhe me përmirësimin e të dhënave si mjeti kryesor për matjen ekonomike të turizmit.
- Mobilizim i aktorëve që merren me turizmin dhe komunikim i vazhdueshëm me komunitetin.
- Kontroll i cilësisë dhe i standardeve në strukturat mikpritëse

Do të konsolidohen 4 destinacione turistike kombëtare; Alpet Shqiptare, Jugu i Ri, Portet e Marinat, Tirana;

- Alpet Shqiptare - Një destinacion i bazuar në ecjen në mal (trekking), kjo e lidhur me natyrën, aktivitetin dhe turizmin sportiv.
- Plazhet e Jugut dhe kombinimi me malet. Aeroporti i ri në jug do të sjellë një përmirësim të rëndësishëm.
- Marinat dhe portet kanë një potencial të lartë për thithjen e turistëve të huaj dhe megjithëse në Shqipëri është rritur hyrja nga deti janë mundësitë të zhvillohen edhe 6 pika të reja portuale me shkallë të lartë shfrytëzimi.
- Tirana do të vazhdojë të përmirësohet në infrastrukturë për ta kthyer atë në një qender atraktive për evente të biznesit rajonal dhe vizitorët e fundjavës, por edhe qendër kulturore e turistike.

Investimi në dije dhe aftësi do të jetë prioritet për zhvillimin e turizmit. Kjo do të synojë nxitjen e një force punëtore me arsimin dhe aftësitë e duhura në sektorin e turizmit, duke theksuar edukimin dhe trajnimin e vazhdueshëm të personelit në të gjitha nivelet.

Në sektorin e turizmit në mandatin e dytë Qeveria do të ndërtojë marketim dhe promovim që do të synojë mediat digjitale dhe sociale rajonale dhe ndërkombëtare.

Shqipëria do të krijojë brandin e vet dhe do ta bëjë atë sa më unik. Ky brand do të promovohet me inteligjencë dhe me mjete inovative; me spote të reja vjetore që do të nxisin kureshtjen për zbulim të destinacioneve të panjohura.

KULTURA DHE TURIZMI KULTUROR

Në mandatin 2017-2021, Qeveria ka prioritet ruajtjen dhe përmirësimin e standardit të cilësisë në prodhimet kulturore, intensifikimin e investimeve në këtë sektor, pavarësimin e skenës kulturore nga strukturat publike (duke shtuar burimet e financimit dhe partneritetet publik-privat) dhe shfrytëzimin e kulturës si burim ekonomie dhe turizmi.

Brenda mandatit 2017-2021 do të përfundojnë punimet për rikonstrukcionin e plotë të Teatrit të Operës dhe Baletit, do të përfundojë qendra multifunktionale e artit “Turbina”, do të investohet në qendra kulturore multifunktionale në qytete ku Rilindja Urbane ka rritur ndjeshëm interesin për kulturën.

Në Tiranë investimet kulturore do të kenë tri prioritete në këtë mandat të dytë: rikualifikim dhe rikonceptim të Muzeut Historik Kombëtar; rikonstrukcion të Bibliotekës Kombëtare; rehabilitim të Galerisë Kombëtare të Arteve si një qendër e rëndësishme e historisë së artit shqiptar. Në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës do të fillojmë gjithashtu ndërtimin për Teatrin e Ri Kombëtar,

dhe ndërtimin e një Muzeu të Artit Bashkëkohor në akset e reja infrastrukturore që po i shtohen kryeqytetit.

Kultura jo si shans për disa, por si e drejtë reale për të gjithë do të konkretizohet në vazhdimin e reformës në institucionet e artit dhe në politikat kulturore, ku do të theksojë me forcë “edukimin përmes kulturës” në standarde profesionale. Edukimi masiv me art e kulturë në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, duke ndërhyrë në kurrikulat e shkollës nga njëra anë dhe duke përfshirë në çdo institucion arti linjën pedagogjike dhe edukative nga ana tjetër, do të jetë prioritet në mandatin e dytë.

Trashëgimia kulturore si një kombinim i programit të Rilindjes Urbane me atë të rehabilitimit të qendrave historike, do të konsolidojë modelin e suksesshëm të rjetësimit të trashëgimisë kulturore me destinacion turistik.

Prioritet do të marrë kombinimi i turizmit kulturor me agroturizmin përmes programit të Rilindjes Rurale që do të synojë restaurimin e qendrave historike të fshatrave me potencial historik si QH Rehovë, QH Theth, QH Dhërmi, QH Vuno, QH Përmet.

Do të promovohen itinerare të reja turistike me karakter kulturor si “Rrugët e besimit”, korridoret e vjetra historike dhe tregtare, si “Via Egnatia”, duke kombinuar trashëgiminë kulturore, kulinarinë dhe artizanatin.

“Rrugët e Kujtesës” janë gjithashtu një itinerar unik i Shqipërisë që do të vijojnë të nxjerrin në pah aspektin historik dhe edukativ të siteve të ish-diktaturës si Spaçi apo Tepelena, në vijim të projekteve tashmë të njohura muzeale të Kujtesës.

Në skenën ndërkombëtare, kultura do të vijojë të forcojë praninë e saj cilësore si pasaporta jonë më e mirë.

3. SHËRBIMET PUBLIKE

3.1 SHTETI LIGJOR DHE DREJTËSIA E RE

Në fushën e drejtësisë Qeveria në 4 vitet e ardhshme do të fokusohet në këto shtylla kryesore:

- Jetësimi i reformës në drejtësi, nëpërmjet ofrimit të gjithë mbështetjes së nevojshme të realizimit të procesit të vetting-ut me sukses, si dhe në procesin e ngritjes së institucioneve të reja qeverisëse dhe drejtuese të gjyqësorit dhe të prokurorisë, të domosdoshme për zbatimin e reformës në drejtësi. Përbushja e të gjitha përgjegjësisë të qeverisë për marrjen e masave me qëllim pasjen e një sistemi drejtësie të pavarur, eficient, të pakorrptuar, profesional dhe të aksesueshëm nga qytetarët.

- Reformë në sistemin e hartimit të legjislacionit dhe në tërësi sistemin e kodifikimit. Do të përmirësohen kapacitetet njerëzore dhe profesionale të këtij sistemi, duke ndryshuar më së pari mënyrën e rekrutimit të personelit përbërës të këtij sistemi. Qëllimi është që ky sistem të jetë i qëndrueshëm dhe personeli i tij të jetë në nivelet më të larta të profesionalizimit të emëruar në bazë të kriterëve meritokratike dhe jo ndryshime politike. Nisjen e një procesi gjithëpërfshirës, transparent, profesional dhe në konsultim me aktorë dhe profesionistë të fushës, për reformimin e kodeve të të drejtës materiale dhe procedurale.

- Reforma tërësore e shërbimeve publike që lidhen me drejtësinë për titujt e pronësisë duke përfshirë rregjistrimin e tyre dhe kthimin dhe kompensimin e pronave. Reforma përfshin mënyrën e organizimit dhe strukturës të institucioneve përkatëse, futjen e teknologjisë dhe informatizimit të shërbimit, rekrutimit të stafit si dhe ofrimin e shërbimit ndaj qytetarit, për ta bërë atë një shërbim cilësor, profesional dhe të shpejtë.

- Reforma e shërbimeve publike të ofruara nga profesionet e lira, (noteria, avokatia, ndërmjetësimi) do të synojë shërbime ligjore, sa më cilësore dhe profesionale për qytetarët. Në këtë kuadër do të forcohen kushtet dhe kriteret profesionale për subjektet që e ofrojnë këtë shërbim publik, si dhe forcimi i mekanizmave kontrollues me qëllim shmangien e abuzimeve dhe veprimeve joligjore. Do të marrë fund praktika e dhënies së lincencave pa asnjë kriter nëpërmjet përfshirjes së mekanizmave filtrues efektiv për ta bërë shërbimin sa më profesional dhe për të shmangur abuzimet.

- Reformim të thellë do të pësojë edhe sistemi i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore nëpërmjet shërbimit përmbarimor. Së pari, do të synojmë thjeshtimin dhe qartësimin e procedurave të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Së dyti, do të rishikohet mënyra e funksionimit dhe organizimit të sistemit të shërbimit shtetëror dhe atij privat të përmbarimit, duke përmirësuar mekanizmat kontrollues të këtij shërbimit të

ofruar tek qytetarët. Qëllimi ynë është që gangrena e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë të marrë fund.

- Pjesë e rëndësishme e këtij procesi reformimi do të jenë edhe institucionet penitenciare, burgjet dhe paraburgimet, si dhe shërbimi i provës, me qëllim rritjen në mënyrë efektive të veprimtarisë së këtyre institucioneve ligjzbatuese në ekzekutimin e vendimeve penale. Reformim rrënjësor do të pësojë mënyra e rekrutimit të stafit policor dhe atij civil, për të shmangur njëherë e mirë emërimet politike, si dhe rritjen e profesionalizmit dhe integritetit të stafit të këtij sistemi.

- Shërbimi ndaj publikut, është një tjetër reformë që do të ndërmerret në këto institucione, së bashku me Platformën e Bashkëqeverisjes, me qëllim që qytetari të ketë derën e hapur për t'u ankuar ndaj shërbimeve jocilësore, të përfitojë këshillim ligjor dhe adresim në kohë të shpejtë dhe sa më profesional të problemeve të tyre. Do t'i japim fund mungesës së papërgjegjshmërisë të administratës publike kundrejt qytetarëve.

RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE

Arritja e standardit të vendeve të BE-së për sa i përket rendit dhe sigurisë publike është sfida e kësaj Qeverie për 4 vitet e ardhshme.

Fokusi i prioriteteve strategjike dhe veprimit në fushën e rendit dhe sigurisë së brendshme do të jetë:

- Forcimi i institucioneve përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike. I gjithë efektivi i Policisë së Shtetit do t'i nënshtrohen procesit të vetting-ut mbështetur në një kuadër ligjor të posaçëm të hartuar dhe monitoruar ngushtësisht dhe drejtpërdrejt nga partnerët ndërkombëtarë. Procesi do të përfshijë edhe një rikonceptim të plotë të sistemit të rekrutimit dhe promovimit, bazuar tërësisht në meritë dhe me karakteristikë themelore transparencën.

- Riorganizimi i sistemit të prezencës së policisë në territor, duke siguruar një kontroll më profesional të tij dhe aplikimin e politikave të "policimit në komunitet". Në kuadër të këtij organizimi, krahas të tjerave, do të punohet për ngritjen e grupeve monitoruese - këshilluese me anëtarë të komunitetit. Ndryshimi cilësor i sistemit të kontrollit të territorit dhe policimit në komunitet do t'i shërbejë para së gjithash parandalimit të kriminalitetit dhe shkeljeve të ligjit. Situata e kriminalitetit në një territor të caktuar do të jetë matësi dhe vlerësimi i punës për çdo punonjës policie përgjegjës për atë territor.

- Lufta pa kompromis dhe ndëshkimi i ashpër penal ndaj grupeve dhe/ose organizatave kriminale të ndryshme, duke goditur çdo aset ekonomik të paligjshëm të tyre, përbën një

prioritet absolut për Qeverinë shqiptare. Ristrukturimi i plotë i strukturave policore të angazhuara në këtë luftë dhe përcaktimi më i mirë i zinxhirit të përgjegjësive së hetimit të çështjeve të tilla, do të jetë prioritet. Do të rishikojmë kuadrin ligjor që lidhet me hetimin e veprave penale, duke synuar forcimin e përgjegjësive të trupës përkatëse hetimore. Do të ndryshojmë, pa cenuar asnjë standard që respekton liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, sistemin e vëzhgimit dhe të mbledhjes së çdo informacioni që lidhet me grupet kriminale, veçanërisht të atyre që janë në trafikun e drogës, përfshi këtu edhe subjekte që kryejnë investime që nuk rezultojnë të kenë aktivitet ekonomik që justifikon të ardhurat e investuara. Me fillimin e funksionimit të institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë besojmë që policia dhe prokuroria do të ndërtojnë besim reciprok dhe bashkëpunim efektiv.

- Mbetet prioritet për Qeverinë e re forcimi i kontrollit në kufij dhe përmirësimi i shërbimit në pikat e kalimit kufitar si kusht për të garantuar lëvizjen e lirë të njerëzve dhe mallrave.

- Ne rikonfirmojmë zotimin e Qeverisë shqiptare për të kthyer në një realitet të konsoliduar atë çfarë arritëm qysh këtë vit - heqjen e vendit tonë nga harta e vendeve kultivuese të kanabisit. Në kuadër të këtij procesi do të investigohet mbi çdo pasuri, të luajshme dhe të paluajshme që është krijuar nga të ardhura të pajustificuara dhe më së shumti të rrjedhura nga trafiku i drogës. Në zbatim të planit kombëtar të veprimit kundër kultivimit të kanabisit Qeveria do të krijojë një sistem eficient mbështetjeje për zhvillimin e ekonomisë bujqësore në territoret e prekura nga kjo dukuri. Do të merren masa të ashpra për të goditur fort rastet e pranishme dhe aksesit ndaj drogave pranë institucioneve arsimore dhe në të gjitha mjediset e frekuentuara nga nxënës dhe studentë.

- Lufta me tolerancë zero ndaj korrupsionit, sidomos korrupsionit në nivelet e larta dhe sekuestrimi e konfiskimi i të ardhurave me origjinë kriminale, asetëve kriminale apo pasurisë së pajustificuar të vënë nga korrupsioni zyrtar përbëjnë një tjetër prioritet për ne si Qeveri.

- Ne do të angazhohemi për përmirësimin rrënjësor të sistemit të kontrollit rrugor, duke synuar krijimin e një kulture europiane në qarkullimin e mjeteve dhe të njerëzve dhe sidomos në menaxhimin e sigurisë rrugore. Numri i punonjësve të policisë rrugore i pranishëm në akset rrugore gradualisht do të reduktohet dhe zëvendësohet nga pajisjet teknologjike. Sistemi i identimit të shkeljeve rrugore do të jetë i informatizuar. Sistemet teknologjike që do të aplikohen me këtë rast do të japin të dhëna në kohë reale edhe mbi mjetet që qarkullojnë, duke identifikuar në kohë reale edhe raste të qarkullimit të mjeteve më të dhëna teknike jo të rregullta dhe/ose të vjedhura, etj.

- Në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, do të hartojmë Strategjinë Kombëtare të Inteligjencës dhe Informacionit, ku do të përfshihen ndër të tjera edhe Ngritja e një Sistemi Kombëtar të Unifikuar të Dhënash (Data Base). Do të ngrihet Shërbimi i Unifikuar i Komunikimit, i Menaxhimit të Fluksit të Dokumenteve të Punës, dhe Teknologjisë së Komunikimit dhe Informacionit si mjete menaxhimi efektiv brenda policisë së shtetit për administrimin e dokumenteve ligjore dhe për koordinimin efektiv me zyrën e Prokurorisë, Prokurorinë speciale dhe Byronë Kombëtare të Hetimit.

- Prioritetet e mësipërme kërkojnë si domosdoshmëri konsolidimin e bashkëpunimit ndërkombëtar me organizatat e specializuara në luftën kundër krimit përfshi dhe asistencën direkte në territorin tonë nga institucionet ndërkombëtare dhe/ose nga shërbimet policore partnere në luftë kundër krimit, kryesisht atij të organizuar. Në këtë kontekst do të përdorim me sukses ngritjen e skuadrave policore mobile të përbashkëta me vendet partnere si mundësi për shkëmbimin e shpejtë të informacionit, kryerjen e operacioneve të përbashkëta të hetimit penal, mbrojtjen më mirë të të dhënave dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë, përdorimin e metodave dhe teknologjisë bashkëkohore, por edhe si një mundësi e mirë për aftësimin e mëtejshëm profesional të strukturave tona policore.

3.1.1 ADMINISTRATA PUBLIKE DHE DIGJITALIZIMI

Objektivi ynë në funksion të rritjes së performancës së administratës publike në 4-vjeçarin e ardhshëm, është krijimi i regjistrave digjitalë të konsoliduar dhe transparentë, akses në internet kudo dhe kurdo dhe mundësimi i shkëmbimit të dokumenteve në format digjital. Me rëndësi të veçantë në këtë drejtim, do të jetë unifikimi i regjistrave të pronës në kadastrën multifunkionale transparente dhe digjitale, përfshirë gjithë hartografinë e pronës. Rishikimi i funksioneve të të gjitha institucioneve dhe agjencive të varësisë me synim restrukturimin e tyre, do të rrisë efikasitetin e institucioneve, do të rrisë cilësinë e shërbimeve dhe do të shmanjë mbivendosjen e funksioneve. Një shpërndarje e re në territor si rrjedhim i natyrshëm i reformës administrative-territoriale dhe i konceptit të ri të rajoneve të zhvillimit, do të ekonomizojë burimet financiare dhe njerëzore e përmirësojë ndjeshëm efikasitetin e institucioneve.

Modernizimi i shërbimeve publike është një prej prioritetëve kryesorë të programit qeverisës, objektivi kryesor i të cilit është evitimi i sporteve fizike, ku kërkohet dokumentacion që gjenerohet dhe administrohet nga vetë shteti e për rrjedhojë, thjeshtëzimi dhe lehtësimi i gjithë procesit falë infrastrukturës digjitale.

Në zbatim dhe të planit “Agjenda Digjitale e Shqipërisë 2015–2020” dhe “Strategjia Ndërsektoriale për Reformën në

Administratën Publike 2015–2020”, do të avancohet ndërlidhja e sistemeve të teknologjisë së informacionit me njëri-tjetrin dhe shkëmbimi i të dhënave në kohë reale mes tyre nëpërmjet Platformës Qeveritare të Ndërveprimit, si hap i domosdoshëm për thjeshtimin e shërbimeve dhe uljen e numrit të dokumenteve që i kërkojnë qytetarit apo biznesit në sportel.

Njëkohësisht do të ndërmerren hapa konkretë për reduktimin e licencave, lejeve dhe autorizimeve që nevojiten për kryerjen e aktiviteteve në vendin tonë, si dhe për reduktimin në maksimum të afateve të zbatimit për to. Faza e parë e rishikimit do të kryhet brenda vitit 2018, ndërsa do të konsolidohen kushtet e digjitalizimit të plotë të këtij procesi.

Do të sigurojmë aksesin për çdo shqiptar në botën digjitale, çka do të thotë më shumë zhvillim ekonomik dhe social. Sot 60 % e qytetarëve shqiptarë kanë akses në internet. Objektivi ynë do të jetë: 90% e popullsisë të ketë akses në internet deri në vitin 2025.

3.2 ARSIMI, RINIA DHE SPORTI

Për ne, arsimit dhe kërkimit shkencor janë një e mirë publike, themelet e ndërtimit të së ardhmes, rruga kryesore e progresit dhe e përballimit të sfidave të integritit euroatlantik. Busulla jonë mbetet arsimit cilësor sipas standardeve më të mira të Bashkimit Europian.

Pas reformave të rëndësishme në arsim që u kryen në mandatin e parë, në këtë mandat të dytë, qeveria angazhohet të punojë për një sistem arsimor eficient, i cili krijon mundësi të barabarta për shkollim cilësor të të gjithë fëmijëve, pavarësisht origjinës, gjinisë, vendbanimit dhe të ardhurave, duke siguruar një forcë pjesëmarrëse dhe të përgjegjshme, në tregun e punës dhe në shoqëri.

Duke e konsideruar si një përparësi kombëtare të rëndësishme, qeveria do të vazhdojë të rrisë buxhetin për arsimin dhe kërkimin shkencor.

Ky mandat do të jetë mandati i investimeve më të mëdha në arsim. Do të shtojmë kapacitetet e mjediseve mësimore, do të eliminojmë mësimet me turne, do të mundësojmë sistemin e ngrohjes për shumicën dërrmuese të shkollave, do të garantojmë kompletimin e bibliotekave, sallave të IT-së, laboratorëve dhe kabineteve të ndryshme, të bazave prodhuese e eksperimentale, terreneve sportive.

Fushat prioritare të politikës arsimore në mandatin 2017-2021 do të jenë:

- Sigurimi i cilësisë së reformave dhe gjithëpërfshirja, nëpërmjet : rritjes së numrit të fëmijëve që ndjekin arsimin parashkollor dhe përfshirjes së klasës përgatitore në arsimin e detyrues

shëm; reduktimit të numrit të klasave kolektive; sigurimit të transportit të nxënësve në shkollat rurale; hartimit të programeve specifike për arsimimin e grupeve të pafavorizuara. Deri në vitin 2021, çdo fëmijë rom dhe egjiptian, do të regjistrohet në shkollë, 100% e tyre do të mbarojnë arsimin e detyrues dhe 70% më shumë vajza e djem romë dhe egjiptianë do të përfundojnë të gjitha nivelet e arsimit. Do të arrihet fuqizimi dhe zgjerimi i rrjetit të shkollave si qendra komunitare; përmirësimi i infrastrukturës shkollore, shkolla dhe konvikte të reja sipas standardeve europiane; përmirësimi i rezultateve në vlerësimet kombëtare dhe ndërkombëtare (PISA;TIMS); rritja e numrit të punonjësve të shërbimit psiko-social në sistemin e arsimit parauniversitar; realizimi i kurrikulës së përbashkët Shqipëri-Kosovë për mësimin e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë; rritja e autonomisë financiare të shkollës

- Zbatimi i kurrikulave bazuar në standarde të krahasueshme me vendet e BE-së, nëpërmjet: zbatimit të kurrikulës së re në të gjithë sistemin e arsimit parauniversitar; përgatitjes dhe ofrimit në shkolla të paketave burimore didaktike; përgatitjes së teksteve specifike për pakicat kombëtare; digjitalizimit të kurrikulës së APU-së.

- Fuqizimi i TIK-ut në arsim, nëpërmjet: hartimit të një platforme dhe plani kombëtar veprimi për zbatimin e TIK-ut në arsim; krijimit të një infrastrukture të qëndrueshme, gjerësisht të përdorshme si dhe të burimeve digjitale në shkolla; zhvillimit të aftësive pedagogjike të mësuesve për përdorimin e TIK-ut; përmirësimin të sigurisë në internet për fëmijët dhe të rinjtë; realizimit të përzgjedhjes online të vendit të punës nga fituesit e portalit “Mësues për Shqipërinë”.

- Përmirësimi i sistemit të administrimit në arsim nëpërmjet: riorganizimit të sistemit të administrimit; riorganizimit të institucioneve të varësisë në Agjencinë për Sigurimin e Cilësisë në APU; mbështetjes financiare për të rekrutuar mësues të kualifikuar në zonat e largëta; kualifikimit dhe licencimit të drejtuesve të shkollave.

- Arsimit i lartë cilësor dhe i orientuar nga tregu i punës: do të përmbyllem akreditimin ndërkombëtar për IAL-et; do të përmbyllem brenda vitit të parë të mandatit gjithë kuadrin institucional e rregullator për të vënë plotësisht në funksion mekanizmat e reformës; do të realizojmë dhe standardizojmë Anketën Kombëtare Studentore, si instrument vlerësimi të çdo universiteti; do të krijojmë platformën unike digjitale për të dhënat në arsimin e lartë; do të rrisim numrin e aplikimeve në kolegjet profesionale; do të mbështesim rolin e universiteteve si qendra të zhvillimit ekonomik e social të vendit.

- Reformimi i sistemit të kërkimit shkencor dhe të financimit

të tij, duke i dhënë prioritet poleve kërkimore universitare: do të mbështesim rolin e universiteteve si qendra të zhvillimit ekonomik e social të vendit; do të mbështesim prezencën e universiteteve shqiptare publike dhe private në programet europiane të kërkimit shkencor; do të miratojmë strategjinë për shkencën 2017 -2021.

RINIA

Ne synojmë zhvillimin e politikave rinore me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës së të rinjve, përmes rritjes së pjesëmarrjes në jetën publike dhe në vendimmarrje; rritjes së mundësive për punësim rinor; përmirësimin të legjislacionit dhe të infrastrukturës në shërbimin e tyre.

Fuqizimi dhe përfshirja e të rinjve në programet kombëtare dhe ndërkombëtare, në rrjetet e shkëmbimit të eksperiencave europiane, iniciativat vullnetare rajonale e botërore, nismat rinore sociale dhe akademike, janë qëllimi madhor i kësaj qeverie. Rritja e numrit të përfutësve në rrjetet ndërkombëtare si Erasmus+; plotësimi i plotë i kuadrit ligjor mbi vullnetarizmin dhe shtimi i përfutësve; nxitja dhe bashkëveprimi mes institucioneve dhe organizatave rinore; përmirësimi i infrastrukturës nëpërmjet hapjes së qendrave rinore në çdo qark. Të gjitha këto do të jenë lokomotiva e zhvillimit të rinisë dhe e formimit të gjeneratës së re shqiptare, një gjeneratë të cilës do t'i ofrohet çdo mundësi për formësim europian.

SPORTI

Në mandatin 2017-2021, Qeveria do të vazhdojë të mbështesë pushtetin vendor në shtimin e ambienteve sportive për qytetarët. Do të synohet që rikonstruksioni apo ndërtimi i çdo shkolle të përfshijë edhe ambientet sportive, si dhe do të konsolidohet kurrikula e sportit në arsimin parauniversitar. Gjatë këtij mandati do të vazhdojnë investimet për infrastrukturën sportive dhe do të përfundojnë plotësisht dy investime shumë të rëndësishme, Arena “Kuq e Zi” dhe Parku Olimpik i Tiranës. Kombëtarja jonë e futbollit dhe mbështetësit e saj do të kenë një impiant modern të standardeve europiane për t'u përfaqësuar denjësisht dhe në kushte shumë të mira në arenën ndërkombëtare.

3.3 SHËNDETËSIA DHE KUJDESI SOCIAL

MBULIMI SHËNDETËSOR UNIVERSAL

Nën moton “shëndet për të gjithë” ne do të vazhdojmë të promovojmë jetën e shëndetshme, duke rritur investimet në të gjithë sektorët që lidhen me shëndetin për të shkuar kështu drejt shëndetësisë falas.

Nën moton “më shumë vite jetës dhe më shumë shëndet viteve” ne do të vijojmë të mbështesim fort parandalimin dhe diagnosti-

kimin e hershëm, sepse prirjet demografike po krijojnë një profil të ri epidemiologjik: jetëgjatësia po rritet, sëmundjet jongjitëse dhe numri i të sëmurëve me disa sëmundje njëherësh po shtohen. Do të zgjerohen programet e parandalimit të disa prej sëmundjeve kanceroze veçanërisht të përhapura te gratë.

Për ne shëndeti mbetet një e mirë publike, prandaj financimi publik për kujdesin shëndetësor synohet të arrijë 60-65% të shpenzimeve totale të shqiptarëve për shëndetësinë (e gjetëm 43% në vitin 2013), duke siguruar që asnjë familje shqiptare të mos bjerë në varfëri për shkak të pagesës për kujdes shëndetësor.

Do të zgjerojmë ndjeshëm kujdesin shëndetësor pa pagesë për fazën e rehabilitimit të sëmundjes për të shkurtuar kohën e qëndrimit në institucione shëndetësore, periudhën e invalidizimit dhe për të pakësuar barrën që deri më sot përballohet nga vetë buxhetet familjare.

Qeveria do të vazhdojë politikën për uljen e çmimit të barnave, duke ruajtur cilësinë, duke rritur disponueshmërinë. Do të ngremë sistemin e gjurmimit, do ta bëjmë shërbimin cilësor farmaceutik të disponueshëm në të gjithë territorin.

Vëmendje të veçantë do të tregohet për fëmijët me aftësi të kufizuara, duke mundësuar kujdes socio-shëndetësor në qendra të specializuara.

Rritja e jetëgjatësisë kërkon gjithashtu rritje të kujdesit shëndetësor për moshën e tretë. Qeveria do të zgjerojë mbështetjen për rehabilitimin, kujdesin paliativ dhe geriartrik.

Në vitin 2018 do të fillojë zbatimi i një programi 10-vjeçar për funksionimin e qendrave komunitare në të gjithë vendin për të koordinuar dhe ofruar shërbime në shëndetin mendor, kujdesin paliativ, shërbimet ndaj të rinjve, kontrollin e substancave abuzuese.

Të vetëdijshëm se mbulimi universal bëhet i prekshëm për qytetarët nëse shoqërohet me qasje në shërbim dhe cilësi universale, ne do të investojmë në infrastrukturë institucionesh shëndetësore, teknologji biomjekësore dhe burime njerëzore me qëllim që kujdesi shëndetësor bashkëkohor të ofrohet sa më pranë vendbanimit të qytetarëve.

Kantieri tashmë i hapur i shëndetësisë do të zgjerohet me vepra të reja të infrastrukturës spitalore, duke shfrytëzuar financimet publike dhe partneritetin publik privat. Vëmendje të veçantë do t'u kushtojmë qendrave spitalore universitare dhe spitaleve rajonale.

Do të vijojmë bashkëpunimin me institucionet jopublike shëndetësore për të plotësuar ofertën e financuar me paratë publike,

si dhe për të ulur në afate të pranueshme kohën e pritjes për ekzaminime dhe/apo trajtime të specializuara.

Deri në vitin 2021, koha e pritjes për të gjitha shërbimet spitalore do të përgjysmohet. Qeveria do të inkurajojë procesin e akreditimit të të gjithë spitaleve publike dhe private.

Urgjenca mjekësore në territor do të forcohet në kapacitete njerëzore, mjekësore e motorike. Thirrjeve të rasteve urgjente do t'iu përgjigjemi brenda 10–15 minutave në zonat urbane dhe 20–35 minutave në zonat rurale. Do të fuqizohen kapacitetet qendrore dhe rajonale për të përballuar urgjencat kardio-vaskulare dhe cerebrale-vaskulare.

Projektet e investimeve në shëndetësi do të zgjerohen me vepra të reja të infrastrukturës spitalore, duke shfrytëzuar financimet publike dhe partneritetin publik-privat. Vëmendje do t'u kushtohet qendrave spitalore universitare dhe spitaleve rajonale. Brenda vitit 2020 me anë të PPP do të ndërtohet spitali rajonal i Fierit si qendër ekselence shërbimesh për qytetarët. Brenda vitit 2021 do të ndërtohen 8 qendra të reja shëndetësore.

KUJDESI SOCIAL

Në këtë mandat, në fushën e pensioneve do të synojmë të rrisim të ardhurat nga kontributet me rreth 30 përqind dhe numrin e kontribuesve në rreth 1 milion në vitin 2021, duke përmirësuar ndjeshëm raportin përfitues-kontribues, si dhe duke ulur edhe më tej deficitin e skemës së pensioneve.

Emigrantët mund të përfitojnë pension bazuar në kontributet e paguara në Shqipëri dhe në vendin e emigrimit. Dhjetë marrëveshjet e nënshkruara gjatë mandatit qeverisës 2013-2017 në fushën e sigurimeve shoqërore do të pasohen me nënshkrimin e marrëveshjeve me vendet e tjera të BE-së gjatë katër viteve që vijojnë.

Politikat tona do të mundësojnë uljen me 10% të punës së paguar të grave, duke rritur aksesin në shërbimet sociale si çerdhe, kopshte, shërbime për moshën e tretë, shërbimet për gratë me aftësi të kufizuara, rome, egjiptiane, si dhe nënat me fëmijë me aftësi të kufizuara.

Gjatë katër viteve të ardhshme do të rrisim punësimin dhe do të përgjysmojmë diferencën midis papunësisë rinore e papunësisë së përgjithshme, nëpërmjet mbështetjes së programeve “start-up”, shkollimit, formimit profesional dhe korsive preferenciale në treg për punësimin e vajzave dhe djemve.

Tri qendrave rinore të ngritura në Tiranë, Vlorë dhe Korçë do t'i shtohen edhe nëntë të tjera në Dibër, Kukës, Shkodër, Lezhë, Elbasan, Durrës, Berat, Fier dhe Gjirokastrë.

Programi i ndihmës ekonomike do të zëvendësohet nga programi “Mbështetje për riintegrim”, i cili do të kushtëzojë e plotësojë ndihmën financiare për familjet e varfra me përfshirjen e tyre në programe e shërbime të personalizuara arsimore, shëndetësore, formimi, punësimi. Do të rritet aksesin në ndërmarrjet sociale, në biznesin social dhe punët komunitare.

Gjatë mandatit tonë të parë, ne trefishuam ndihmën ekonomike nga 1.5 mijë në 4.5 mijë dhe nga 3 mijë në 8 mijë lekë. Deri në vitin 2021, një në dy familje përfituese të mbështetjes për riintegrim do të përfshihen në programin “Shqipëria punon”, duke mundësuar që deri në vitin 2025 në këtë program të përfshihen tre në katër familje.

Do të vijojë të jetë maksimale vëmendja ndaj të përndjekurve politikë dhe familjeve të tyre. Gjatë mandatit tonë të dytë do të përfundojmë dëmshpërblimin e kësaj kategorie dhe do të mbështesim integrimin dhe pjesëmarrjen e tyre shoqërore, ekonomike e politike.

4. POLITIKA E JASHTME DHE E SIGURISË, INTEGRIMI EUROPIAN DHE SHQIPTARËT NË BOTË

Përpjekjet tona drejt anëtarësimit në BE janë intensifikuar ndjeshëm, duke siguruar jo vetëm marrjen e statusit kandidat, por edhe marrjen e rekomandimit për çeljen e negociatave për anëtarësim.

Shqipëria ka rritur besueshmërinë e saj pranë partnerëve strategjikë, si një aktor besnik përkundrejt politikës së jashtme dhe të sigurisë të Bashkimit Europian dhe NATO-s.

Kemi siguruar respektim më të madh të të drejtave themelore të shqiptarëve në rajon (Mal të Zi, Maqedoni dhe Serbi), duke lehtësuar iniciativat që fuqizojnë zërin dhe kushtet e përfaqësimit të tyre.

NJË SHQIPËRI E FORTË NË RAJON DHE E BESUESHME BRENDA KORNIZËS EUROATLANTIKE

Programi ynë qeverisës për politikën e jashtme dhe të sigurisë 2017-2021 synon të konsolidojë pozitat e Shqipërisë në hapësirën e Europës Adriatike, të rrisë edhe më tej angazhimin e vendit në strukturat euroatlantike, të mbrojë të drejtat e patjetërsueshme të shqiptarëve në rajon, të rrisë kapacitetet e mbrojtjes dhe të intensifikojë ritmin e procesit të integritimit në Bashkimin Europian. Shqipëria do të vijojë të kundërshtojë agjendat nacionaliste që kanë penguar rajonin vite me radhë dhe të parandalojë agjendat radikale që synojnë ndërprerjen e progresit tonë në familjen euroatlantike.

Vizioni ynë për një Shqipëri të fortë dhe të besueshme mbështetet mbi partneritetin strategjik me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Europian, si dhe mbi një pozicionim realist dhe dinamik brenda katërkëndëshit strategjik rajonal (Itali - Austri - Greqi - Turqi) ku artikulojnë interesat kombëtare të Shqipërisë, si një vend i kyçur në Ballkan dhe i hapur në Mesdhe.

Angazhimi ynë në NATO synon të përforcojë pozitat e Shqipërisë si një vend që prodhon dhe duhet të rrezatojë stabilitet.

Shqipëria dhe Kosova, dy shtete me një partneritet strategjik të natyrshëm dhe vëllazëror, do të synojnë të përfitojnë së bashku dhe në mënyrë komplementare nga procesi i integritimit evropian dhe iniciativat rajonale. Mbledhjet e dy qeverive do të vijojnë të funksionojnë si mekanizmi koordinues për harmonizimin e politikave ekonomike dhe infrastrukturore, si dhe projektimin e investimeve të përbashkëta për fuqizimin e tregut të punës në mbarë hapësirën shqiptolëse.

Shqipëria do të vijojë të jetë pararendëse në procesin e Berlinit dhe dinamikat e reja rajonale, duke bashkërenditur aksionin e saj me atë të Gjermanisë, si një partner i pazëvendësueshëm i

Shqipërisë dhe shqiptarëve, që i kushton vëmendje të posaçme rajonit tonë. Gjithashtu, marrëdhëniet me Francën do të vijojnë të jenë dinamike në rrafshin ekonomik dhe atë të sigurisë.

Marrëdhënia me Italinë mbart një rëndësi strategjike të veçantë, si një promovuese e ambicies europiane të Shqipërisë dhe përcaktuese për dimensionin mesdhetar të politikës sonë të jashtme. Marrëdhëniet e shkëlqyera me Austrinë, do të vijojnë të thellohen në dinamikën e mbarëvajtjes së proceseve integruese të rajonit. Marrëdhëniet me Greqinë dhe Turqinë kanë një dimension strategjik, si vende anëtarë të BE-së dhe të NATO-s, influenza dhe rrezja e veprimtimit të cilave është thelbësore në Ballkan dhe Mesdhe.

Shqipëria do të vijojë në rrugën e dinamizimit të marrëdhënieve të shkëlqyera politike dhe ekonomike me Kinën, sikundër dhe me partnerë të tjerë të rëndësishëm të Azisë dhe Paqësorit.

Në besojmë se rikthimi në Europë i Shqipërisë dhe rajonit kalon përmes normalizimit të marrëdhënieve në Ballkanin Perëndimor, si një proces dinamik, ku dialogu i vazhdueshëm, pa tabu dhe pa komplekse, rimëkëmb besimin tek vetja dhe tek fqinjët.

Këtë qasje primore, realiste dhe pa tabu do të vijojmë të kemi përkundrejt mosmarrëveshjeve të mbartura nga e kaluara që kemi me Greqinë apo dhe me fqinjët e tjerë.

Të përkujdesesh për shqiptarët në rajon do të thotë gjithashtu të investosh për të ardhmen dhe mirëqenien e tyre. Qeveria shqiptare do të angazhohet për të mbështetur, përmes një fondi të posaçëm, projektet e iniciuara nga komunat, institucionet kulturore, arsimore, shëndetësore apo shoqëria civile shqiptare në rajon.

SIGURIA KOMBËTARE DHE KONTRIBUTI NË SIGURINË GLOBALE

Koncepti ynë për sigurinë kombëtare shkon përtej përkufizimit klasik dhe nënkupton elementet e sigurisë kibernetike dhe asaj energjetike apo klimaterike.

Programi ynë për mbrojtjen dhe sigurinë synon një rritje graduale të kapaciteteve ushtarake të Shqipërisë, duke trupëzuar standardet dhe parimet e Aleancës së Atlantikut të Veriut dhe duke vijuar angazhimin tonë operacional maksimal në misionet e mbrojtjes kolektive dhe ato paqeruajtëse të drejtuara nga Aleanca.

Në periudhën kohore 2017-2021 Shqipëria do të synojë një rritje graduale dhe domethënëse të buxhetit të mbrojtjes, në përm-bushje të angazhimit tonë përkundrejt NATO-s në Uells dhe në Varshavë për t'i dedikuar 2% të PBB-së shpenzimeve të mbrojtjes deri në vitin 2024.

Programi ynë i mbrojtjes dhe i sigurisë është pikë së pari një projekt shoqëror, falë të cilit, shërbimi vullnetar ushtarak, apo civil, mund të jetë instrument formimi profesional për të rinjtë, dhe të përbjë një eksperiencë, ku formësohen vetëdija kombëtare dhe rritja e kapaciteteve nuk nënkupton vetëm më shumë burime financiare por njëkohësisht shpenzime më të arsyeshme që i mundësojnë Forcave tona të Armatosura të specializohen në ato fusha ku mund të krijojnë avantazhe krahasuese. Një vëmendje e posaçme në këtë drejtim do i jepet Forcës Detare.

Brenda vitit 2019 do të krijohet njësi ushtarake e sigurisë kibernetike në bashkëpunim me partnerët tanë strategjikë.

Gjithashtu, brenda vitit 2019 do të realizojmë gatishmërinë operationale të Grup-Batalionit të Këmbësorisë së Mekanizuar, duke përbushur në këtë mënyrë detyrimet ndaj NATO-s në kapacitetet ushtarake.

Përmirësimi dhe modernizimi i mëtejshëm i menaxhimit të kufijve, rritja e kapaciteteve të bashkëpunimit dhe të shkëmbimit ndërkombëtar të të dhënave dhe informacionit do të kontribuojnë në parandalimin dhe frenimin e qarkullimit ndërkufitar të krimit, terrorizmit, financave kriminale dhe migracionit të paligjshëm.

CILËSI DHE RITËM DHE NË PROCESIN E ANËTARËSIMIT NË BE

Programi ynë për integrimin european synon fillimin, sa më parë, të procesit të negociatave për anëtarësim dhe përmbylljen e kapitujve kryesorë në këtë proces të pakthyeshëm për realizimin e aspiratës europiane të vendit. Shërbimi diplomatik do të jetë në pararojë të këtij procesi në funksion të një bashkëpunimi më të strukturuar me vendet anëtare BE-së.

Kjo qasje e re do të sjellë gjithashtu një racionalizim të burimeve njerëzore, duke integruar dhe duke centralizuar struktura apo drejtori që në të kaluarën kanë operuar në kushte mbivendosjeje. Cilësia e procesit të integritetit lidhet drejtpërdrejt me projektet e bashkëpunimit rajonal, ku do të synojmë një përputhje më të mirë të prioritetëve politike të përcaktuara dhe instrumenteve financiarë që Shqipëria ka në dispozicion. Nga ana tjetër, shpejtësia e procesit të integritetit lidhet gjithashtu me dinamikën e përfaqësimit tonë diplomatik në vende dhe në momente kyçe, ndaj dhe Qeveria jonë do të synojë fuqizimin e shërbimit diplomatik në vende kyçe për mbarëvajtjen e procesit të anëtarësimi.

SHQIPTARËT NË BOTË

Përtej dallimeve midis diasporës së vjetër dhe asaj të re, ne e konsiderojmë diasporën si një aleate strategjike të diplomacisë tonë. Qeveria do të krijojë kushtet për një marrëdhënie të strukturuar me gjithë shqiptarët në botë, kudo ku ata jetojnë. Përtej dallimeve midis diasporës së vjetër dhe asaj të re, ne e konsiderojmë

diasporën si një aleate strategjike të diplomacisë tonë. Qeveria do të krijojë kushtet për një marrëdhënie të strukturuar me gjithë shqiptarët në botë, kudo ku ata jetojnë.

Organizimi i “Samitit të Diasporës” vlerësohet si fillimi i ndërtimit të një politike të re për një përfshirje të diasporës dhe shtetasve shqiptarë në emigracion në punët dhe mirëqenien e vendit. Në këtë kuadër do të fillojë një reformë institucionale dhe ligjore, e cila do t'i japë kësaj pjese të shoqërisë të drejtën e votës atje ku ajo banon. Ky proces do të paraprihet nga ndërtimi i strukturave shtetërore, të cilat do të ndërtojnë një marrëdhënie të natyrshme të atdheut me shtetasit e vet që mbajnë lidhjet me vendlindjen.

Për këtë qëllim do të krijohet një Agjenci Shtetërore e emigracionit dhe do të fillojë regjistrimi i tyre aty ku ata janë. Pjesë e natyrshme e kësaj reforme do të jetë edhe një politikë e nxitjes së kthimit të tyre në atdhe si forcë e kualifikuar e punës apo si pjesë e investimeve në ekonomi nga ana e diasporës më të suksesshme, bazuar në modele, të cilat vende me emigracion të zhvilluar i kanë zbatuar me sukses. Krijimi i një Fondi për këtë qëllim do të konsiderohet fillimi i një praktike e cila së bashku me të drejtën e votës do të krijojë një politikë shtetërore që do të angazhojë në zhvillimin e vendit këtë shtresë vitale të kombit.

Prandaj do të investojmë më shumë në infrastrukturën konsullore dhe platformat digjitale për të mundësuar zgjerimin e gamës së shërbimeve konsullore, për të rritur transparencën.

Do të vijojmë gjithashtu të përmirësojmë politikën tarifore të shërbimeve konsullore, duke synuar gjithnjë shërbime më të lira dhe më të sigurta, që nga legalizimet e deri tek vizat.

Brenda gjysmës së parë të mandatit qeverisës do të përfundojmë procesin e regjistrimit të shtetasve tanë jashtë vendit për t'i dhënë mundësinë shqiptarëve me banim jashtë vendit të ushtrojnë të drejtën e tyre të votës në zgjedhjet parlamentare të vitit 2021.

DIPLOMACIA NË SHËRBIM TË ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE PROMOVIMIT TË VENDIT

Diplomacia ekonomike do të jetë në pararojë të përpjekjeve për përthithjen e investimeve të huaja dhe krijimit të vendeve të reja të punës.

Do të nisim fazën e dytë të racionalizimit të përfaqësimit tonë diplomatik, duke fuqizuar përfaqësitë tona në vende dhe misione kyçe për të ardhmen.

Falë eksperiencës së konsoliduar që kemi me konsullatat e përbashkëta me Kosovën, do të synojmë zgjerimin e përfaqësimit tonë në hapësira të tjera gjeografike si Azia Juglindore dhe Paqësori, duke pasur gjithnjë në fokus përkujdesjen për shtetasit tanë.

Diplomacia publike, diplomacia digjitale dhe ajo kulturore, me ndikim të drejtpërdrejtë në imazhin e vendit, do të fuqizohen edhe më shumë, duke shfrytëzuar më së miri kapacitetet e ministrive dhe agjencive përkatëse.

Brenda këtij mandati qeverisës, Shqipëria do të ketë pranë përfaqësive të saj diplomatike dhe institute të bashkëpunimit kulturor dhe shkencor që do të operojnë si instrumente të rrezatimit tonë kulturor për të huajt dhe diasporën.



PROGRAMI QEVERISĒS
2017-2021
